

Në bazë të nenit 25, alineja 16 të Statutit të FBK-së, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23.09. 2009 aprovoi këto:

## **PROPOZICIONE TË GARAVE TË KAMPIONATIT TË KOSOVËS NË BASKETBOLL, PËR EDICIONIN 2009/10**

### **Neni 1**

Përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e garave është Komesari i Garave të cilin e emëron dhe shkarkon Bordi i FBK.

Delegimin e gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve për ndeshjet e të gjitha ligave e bën Komesari i Garave.

Komesari i garave krijon marrëdhënie pune me FBK dhe është pjesë e zyrës së Federatës.

Mandati i komesarit është një edicion garues.

Për punën e tij në udhëheqjen dhe organizimin e garave i përgjigjet Bordit.

### **Neni 2**

Sistemin e Garave, mënyrën e zhvillimit, kalendarin dhe numrin e klubeve në të gjitha ligat e aprovon Bordi i FBK-së.

### **Neni 3**

Garat e Super Ligës zhvillohen me sistem të pikëve.

Ndeshjen e organizon skuadra vendase, sipas orarit të aprovuar të garave.

Skuadra vendase nuk mund të organizojë dhe të zhvillojë ndeshjen në fushën e skuadrës mike.

Kalendari i aprovuar i garave nuk mund të pësojë ndryshime, përveç rastit kur në pyetje janë rrethanat e jashtëzakonshme ose interesi i basketbollit.

Vendimin për ndryshimin e kalendarit të garave, e bie Bordi i FBK-së.

### **Neni 4**

#### **1.Superliga**

Super Liga numëron 8 skuadra

1. Bambi
2. Sigal Prishtina
3. Eurosporti
4. Peja
5. Trepça
6. RCC Drita
7. BB Bashkimi
8. Kosova

## **Neni 5 SUPERLIGA**

Në edicionin garues 2009/10,liga do të numëroje 8(tetë) skuadra,luhet me sistem të dyfishhtë(stinori vjeshtor dhe pranveror) 2(dy)herë vajtje-ardhje.Në fund të kampionatit të rregullt,skuadrat e renditura në pozitat 1 – 4,inkuadrohen në play-off.Skuadra e renditur në pozitën e 8(tetë) të tabelës së klasifikimit largohet nga liga,ndërsa skuadra e renditur në pozitën e 7(shtatë),luan në paly-out,kundër skuadrës së renditur në pozitën e 2(dytë) nga Liga e Parë.Superliga ne edicionin 2010/11 do të numërojë 8(tetë) skuadra.(Mund të ketë ndonjë ndryshim eventual që vlerësohet nga Kuvendi apo Bordi i FBK-s,se është në dobi të avancimit të basketbollit te sistemi i garës në play-out apo largimi nga liga)

Pas përfundimit të garave,në play-off për titullin e kampionit të Kosovës marrin pjesë 4(katër) skuadrat e para të renditura në fund të kampionatit të rregullt.

### **PLAY-OFF**

Gjysmëfinalja

Çifti A: 1 – 4

Çifti B: 2 – 3

Fitues i çdo çifti është skuadra i cila arrinë 2(dy) fitore.

Ndeshja e parë zhvillohet në fushen e skuadrës,e cila ka në renditjen e garës së rregullt ka klasifikim më të mirë,ndeshja e dytë në fushën e skuadrës me klasifikim më të dobët dhe ndeshja e tretë eventuale,në fushën e skuadrës me klasifikim më të mirë.

Finalja

Gara finale zhvillohet ndërmjet skuadrave fituese të çifteve A dhe B.

Fituese e garës finale është skuadra,e cila shënon 3(tre) fitore.

Ndeshja e parë zhvillohet në fushën fushën e skuadrës,e cila ka klasifikim më të mirë në renditjen e garës së rregullt,e dyta në fushën e skuadrës me klasifikim më të dobët,e treta në fushën e skuadrës me klasifikim më të mirë dhe e katërta në fushën e skuadrës me klasifikim më të dobët.Nëse pas zhvillimit të katë ndeshjeve,numri i fitoreve është i barabartë(2:2),atëherë ndeshja e pestë zhvillohet në fushën e skuadrës me klasifikim më të mirë në renditjen e garës së rregullt.

## **2. Liga e Parë-Meshkujt**

Faza e parë: Liga e pare e Meshkujve në edicionin 2009/2010do të përbëhet prej skuadrave të cilat janë të gatshme që të gjitha ndeshjet e tyre të i zhvillojnë në Palestra sportive. Forma e garave do të përcaktohet ne bashkëpunim me klubet.

Faza e dytë: Skuadrat tjera dhe dy të parat nga Liga e dytë vazhdojnë në pranverë për të përcaktuar të parin i cili luan në play-out me të katërtin e SuperLigës B. Forma e garave do të përcaktohet ne bashkëpunim me klubet.

## **Neni 6**

### **Liga e Dytë –Meshkujt**

Skuadrat të cilat nuk kanë mundësi të zhvillojnë garat në Palestra do të luajnë në Ligën e dytë të Kosovës. Sistemi i garave në formë lige apo Turneu do të përcaktohet varësisht nga numri i skuadrave të interesuara se paku 15 dite para fillimit të garave.

## **Neni 7**

Liga e Femrave numëron 8 skuadra të cilat luajnë me sistem të dyfishtë. Katër skuadrat e para plasohen në play-off,ku luan deri në dy fitore me sistem klasik i pari më të katërtin e dyti me të tretin. Fituesit takohen në finale. Të gjitha ndeshjet e play-offit zhvillohen deri në dy fitore. Përparësinë e terrenit vendas e kanë skuadrat me plasman më të mirë në Ligë. Në rast të ndryshimit të numrit të skuadrave(rritje apo zvogëlim) Bordi i FBK përcakton sistemin e garave më së largu 3 ditë para fillimit të kampionatit.

## **Neni 8**

### **LIGA E JUNIORËVE –**

Juniorë konsiderohen të gjithë lojtarët e lindur në vitin 1992 dhe 1993. Për Juniorë mund të luajnë edhe lojtarë më të rinj me lejen speciale të specialistit të mjekësisë sportive.

***Skuadra e cila aktivizon lojtarë që nuk përputhen me moshën e juniorit,pasi është verifikuar se janë të regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara i shlyhen të gjitha rezultatet, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm në atë kategori, ndërsa ndaj personave përgjegjës organi i autorizuar disiplinor i FBK-s do të merr masa ndëshkuese në bazë të Rregullores disiplinore të FBK-s.***

### **Liga UNIKE**

Liga numëron - skuadra dhe do të luhet me sistem të dyfishtë. Katër skuadrat e para plasohen në play-off,ku luan deri në dy fitore me sistem klasik i pari më të katërtin e dyti me të tretin. Fituesit takohen në finale. Të gjitha ndeshjet e play-offit zhvillohen deri në dy fitore. Përparësinë e terrenit vendas e kanë skuadrat me plasman më të mirë në Ligë.

## **Neni 9**

### **LIGA E KADETËVE-Gara Preleminare**

Kadetë konsiderohen të gjithë lojtarët e lindur në vitin 1994 dhe 1995. Për Kadetë mund të luajnë edhe lojtarë më të rinj me lejen speciale të specialistit të mjekësisë sportive.

Luhet me sistem të grupeve (4,kater grupe),bartës të grupeve janë skuadrat e renditura në pozitat 1-4 nga edicioni i kaluar, kurse grupet formohen radhazi sipas renditjes tabelare nga të dy ligat. Luhet me sistem vajtje-ardhje.Për pjesen e dytë të kampionatit(Ligen unike) plasohen nga (2)dy skuadra të renditura si të parat e secilit grup.

***Skuadra e cila aktivizon lojtarë që nuk përputhen me moshën e kadetit, pasi është verifikuar se janë të regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara i shlyhen të gjitha rezultatet, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm në atë kategori, ndërsa ndaj personave përgjegjës organi i***

***autorizuar disiplinor i FBK-s do të merr masa ndëshkuese në bazë të Rregullores disiplinore të FBK-s.***

### **Liga UNIKE (e parë)**

Liga numëron 8 skuadra(nga 2 nga secili grup i garave preliminare) dhe do të luhet me sistem të dyfishtë. Katër skuadrat e para plasohen në play-off,ku luan deri në dy fitore me sistem klasik i pari më të katërtin e dyti me të tretin. Fituesit takohen në finale. Të gjitha ndeshjet e play-offit zhvillohen deri në dy fitore. Përparësinë e terrenit vendas e kanë skuadrat me plasman më të mirë në Ligë.

### **LIGA E DYTË**

Skuadrat tjera të grupeve te renditura nga pozita tre(3) e tutje do ta përbëjnë ligen e dytë.Luhet me sistem vajtje-ardhje,për rangim sa më të mirë(nuk do të ketë gara shtesë-play-off).

### **LIGA E PIONIERËVE –Gara Preleminare**

Pionierë konsiderohen të gjithë lojtarët e lindur në vitin 1996 dhe 1997. Për pionierë mund të luajnë edhe lojtarë më të rinj me lejen speciale të specialistit të mjekësisë sportive.

Luhet me sistem të grupeve (4,kater grupe),bartës të grupeve janë skuadrat e renditura në pozitat 1-4 nga edicioni i kaluar, kurse grupet formohen radhazi sipas renditjes tabelare nga të dy ligat. Luhet me sistem vajtje-ardhje.Për pjesen e dytë të kampionatit(Ligen unike) plasohen nga (2)dy skuadra të renditura si të parat e secilit grup.

***Skuadra e cila aktivizon lojtarë që nuk përputhen me moshën e pionierit, pasi është verifikuar se janë të regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara i shlyhen të gjitha rezultatet, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm në atë kategori, ndërsa ndaj personave përgjegjës organi i autorizuar disiplinor i FBK-s do të merr masa ndëshkuese në bazë të Rregullores disiplinore të FBK-s.***

***Në ndeshjet e pionierëve të rinjë (fatosat) dhe pionirëve, është e ndaluar të luhet zona në mbrojtje. Sanksionimi gjatë ndeshjes- një gjuajtje e lirë dhe pronësia e topit.***

***Nëse klubi i ka të paraqitura dy ekipe – ose më shumë, për një kategori, nuk ka të drejtë që nga njëra ekip të aktivizojë lojtarë për ekipin tjetër deri sa ekipet janë në të njëjtin rang të garave.***

***Lojtarin të cilin mosha e lejon që të aktivizohet per dy grupmosha,nuk ka të drejt loje në të njejten ditë në terminin e njepasnjeshem(dy lojë radhazi).***

***Gjatë një edicioni garues klubi ka të drejtë t'i regjistrojë dy lojtarë të klubit tjetër i cili është paraqitur në ligën e të rinjve në atë kategori në afatin e jashtëzakonshëm kalimtar.***

*Nëse ndodhë që ndonjëri lojtarë të regjistrohet jashtë afatit të përmendur, atëherë vie deri te shkëlja e Rregullorës për Regjistrim të FBK, përderisa pasojat do t'i bartin klubi dhe trajneri të cilat janë të përcaktuara në Propozicionet e garave.*

*Klubi i cili nuk e ka të paraqitur ekipin në ndonjëren kategori për garim në ligën e të rinjve mund të jap më së shumti dy lojtarë klubit tjetër i cili e ka paraqitur ekipin në atë kategori.*

## **Liga UNIKE (e parë)**

Liga numëron 8 skuadra(nga 2 nga secili grup i garave preliminare) dhe do të luhet me sistem të dyfishtë. Katër skuadrat e para plasohen në play-off,ku luan deri në dy fitore me sistem klasik i pari më të katërtin e dyti me të tretin. Fituesit takohen në finale. Të gjitha ndeshjet e play-offit zhvillohen deri në dy fitore. Përparësinë e terrenit vendas e kanë skuadrat me plasman më të mirë në Ligë.

## **LIGA E DYTË**

Skuadrat tjera të grupeve te renditura nga pozita tre(3) e tutje do ta përbëjnë ligen e dytë.Luhet me sistem vajtje-ardhje,për rangim sa më të mirë(nuk do të ketë gara shtesë-play-off).

## **Neni 10**

Skuadra vendase është e obliguar të bëjë paraqitjen e datës, ditës dhe orës së zhvillimit të ndeshjes, më së largu 72 orë para fillimit të saj. Paraqitja me shkrim I bëhet Komesarit të Garave dhe skuadrës mike.

Ndryshimi i orarit të zhvillimit të ndeshjes mund të bëhet vetëm me vendimin e Komesarit të Garave.

## **Neni 11**

Nëse ndeshja nuk mund të zhvillohet për shkaqe objektive, siç janë: moti tepër i ligë, fuqi madhore (tërmet, vërshim, zjarr), mosprania e organeve të sigurimit publik- SHPK, ndërprerja e rrymës elektrike, ndërprerja e komunikacionit, pamundësia e zëvendësimit të tabelës së thyer, dëmtimi i pajisjeve, të cilat nuk mund të evitohen ose përlëshjes së përgjithshme të shikuesve, me pamundësi të vazhdimit, sipas vendimit të gjyqtarit të parë, ndeshja mund të pezullohet dhe të zhvillohet brenda 24 orëve vijuese, sipas vendimit të vëzhguesit të ndeshjes.

Nëse nga shkaqet e përshkruara nga **alineja 1** e këtij neni, ekzistojnë arsyet objektive, që ndeshja nuk mund të zhvillohet brenda 24 orëve vijuese, në bazë tëraportit të vëzhguesit të ndeshjes, Komesari i Garave merr vendim për caktimin e terminit të ri për zhvillimin e ndeshjes.

Ndeshja e cila është ndërprerë për shkaqe objektive (ndërprerja e rrymës në pjesën e qytetit ku zhvillohet ndeshja, thyerja e tabelës ose pajisjeve tjera që nuk mund të zëvendësohen) do të vazhdohet duke e llogaritur kohën dhe rezultatin në çastin e ndërprerjes.

Në rastet e jashtëzakonshme kur paraqiten sëmundjet epidemike (gripi,etj) ose ndodh helmimi i të konsiderueshëm i një numri të konsiderueshëm lojtarëve I verifikuar nga Enti i autorizuar shëndetësor,Komesari I garave është I autorizuar të pezullojë ndeshjen(et) të skuadrave të goditura nga sëmundja,për një kohë të caktuar.

Nëse skuadra mike nuk paraqitet në kohën e caktuar për zhvillimin e ndeshjes për shkaqe tjera që nuk janë objektive dhe me kohë nuk e ka lajmëruar Komesarin e Garave, dhe skuadrën vendase për arsyet e mosparaqitjes me kohë në ndeshje, Komesari i Garave, në bazë të raportit të vëzhguesit, këtë ndeshje e regjistron me rezultat zyrtar (20:0) në të mirë të skuadrës vendase, ndërsa skuadrës mike i regjistrohet 0 (zero) pikë në tabelën e klasifikimit.

## **Neni 12**

Pas përfundimit të ndeshjes finale të Play-off-it dhe të Kupës së Kosovës, ku përcaktohet kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës për edicionin 2009/10, në mënyrë solemne bëhet shpallja e fituesit, ndarja e medaljeve dhe mirënjohjeve për lojtarët e ekipeve finaliste. Në këtë solemnitet janë të obliguar të marrin pjesë lojtarët dhe trajnerët e të dyja skuadrave dhe gjyqtarët e ndeshjes.

## **Neni 13**

Të gjitha ndeshjet e të gjitha ligave, Komesari i Garave i regjistron në afatin sa më të shkurtër, e më së largu 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të tyre.

Nëse në ndeshje është paralajmëruar dhe parashtruar ankesë, afati i regjistrimit shtyhet deri në marrjen e vendimit mbi ankesën.

## **Neni 14**

*Ndeshjet e SUPERLIGËS, Ligës së femrave, Ligës së pare të meshkujve, Ligave Unike për kategoritë e reja (juniorët, kadetët dhe pionierët) zhvillohen në palestrat sportive të cilat i plotësojnë kushtet e parashikuara me Rregullat zyrtare të lojës të FIBA-s (fusha e lojës, hapësira rreth bankës së skuadrave, koshat, pajisjet (teknike) të cilat i ka regjistruar Komesari i garave ose Komisioni i veçantë.*

*Fusha e lojës duhet të jetë sipërfaqe e materialit të forte – drurit, me përmasa 28 x 15 m Fusha duhet të jetë e shënuar sipas Rregullave zyrtare të lojës të FIBA-s. Përveç kësaj, çdo hapësirë rreth bankës së skuadrave është e kufizuar me një vijë të gjatë së paku dy (2) m e cila është vazhdim i vijës fundore dhe me vijën tjetër, me gjatësi së paku dy (2) m, e cila është vizatuar në gjatësi prej pesë (5) m nga vija qendrore dhe është pingule me vijën fundore, brenda së cilës trajnerëve iu lejohet lëvizja gjatë ndeshjes, prej së cilës mund të dalin vetëm kur dëshirojnë të komunikojnë me tavolinën e gjyqtarisë (kërkim I pushimit,informata ose vërejtjet në punën e tavolinës së gjyqtarisë) dhe atë vetëm në situata kur parashikohen me Rregullat zyrtare të lojës të FIBA-s.*

*Tavolina e gjyqtarisë vendoset në qendër të fushës së lojës, e larguar së paku dy (2) m jashtë vijës anësore.*

*Në të dyja anët e tavolinës së gjyqtarisë duhet të vendosen nga dy (2) ulëse për lojtarët zëvendësues që presin zëvendësimin.*

*Bankat për zëvendësuesit dhe personat zyrtar dhe përcjellësit e skuadrës (vetëm ata të shënuar në listën e skuadrës) duhet t'i kenë katërmbëdhjetë (14) ulëse dhe të vendosura në të dyja anët e tavolinës së gjyqtarisë( duke filluar nga vija e vazhdimi të vijës fundore dhe vazhduar në drejtim të tavolinës së gjyqtarisë), si dhe të sigurohen nga kontakti i mundshëm i shikuesve.*

*Në palestrat sportive ku zhvillohen ndeshjet e këtyre ligave, është e obliguar të gjendet dhe të funksionojë semafori digjital, i cili dirigjohet nga tavolina e gjyqtarisë. Semafori digjital duhet të tregoj kohën, rezultatin, numrin e gabimeve të lojtarëve dhe numrin e gabimeve të skuadrave. Sipër tabelës së koshit duhet të vendoset aparatura për matjen e 24-sekondëshit.*

*Në qoftë se para fillimit të garave ose gjatë zhvillimit të tyre konstatohet se palestrat sportive nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara, atëherë Komesari I garave e cakton një afat kohor për evitimin e mangësive të konstatuara. Nëse edhe gjatë atij afati kohor nuk evitohen, atëherë Komesari i garave merr vendim për ndalimin e zhvillimit të ndeshjeve në atë palestër.*

*Në qoftë se ndonjë normativ e përcaktuar me këtë Nen nuk është plotësuar dhe ajo mangësi ndikon në kushte për zhvillimin normal të ndeshjes, atëherë vëzhguesi I ndeshjes vendos për lejimin apo jo të ndeshjes.*

#### Neni 15 a

*Ndeshjet e Ligës së dytë të seniorëve dhe Ligës së dytë të kategorive të reja (juniorët, kadetët dhe pionierët) lejohet të zhvillohen në palestra sportive dhe salla të shkollave me përmasa minimale të fushës së lojës 24 x 13 m. dhe pengesa e pare, pas vijave kufizuese, të jetë medoemos së paku 1 m.*

*Për tavolinën e gjyqtarisë (e larguar së paku 1 m nga vija anësore) duhet të sigurohen:*

- Dy (2) kronometra dore për matjen e kohës së lojës dhe 24-sekondëshit.
- Protokoll i zyrtar i lojës i FBK-s
- Treguesit e gabimeve të lojtarëve
- Treguesit e gabimeve të skuadrave.
- Treguesi (shigjeta) e zotërimit të alternuar
- Dy (2) lapsa me ngjyra të ndryshme
- Formularët e nevojshëm për raportin e vëzhguesit.

#### Neni 15

*Ndeshjet e të gjitha ligave zhvillohen me topa basketbolli të materialit të lëkurës "MOLTEN"(Meshkujt GL 7,Femrat GL 6).*

*Skuadra vendase është e obliguar t'i vë në dispozicion 2 (dy) topa skuadrës mike për nxehje, ndërsa gjyqtarit të parë, topin me të cilin do të fillojë ndeshja.*

*Në qoftë se skuadra vendase nuk e bën këtë, gjyqtari i parë mund ta zgjedhë topin e skuadrës mike për zhvillimin e ndeshjes.*

#### Neni 16

*Skuadra vendase duhet ta respektojë ngjyrën e fanellave të skuadrës mike.*

Rekomandohet që skuadra vendase të vishet me fanella me ngjyrë të ndritshme, ndërsa skuadra mike me ngjyrë të mbylltë.

Fanellat e lojtarëve duhet të shënohen me numra, sipas rregullave të lojës në FIBA. Por në ligat nacionale lejohen edhe nr. prej 4 – 25; prej 30 – 35 ; prej 40 – 45 ;prej 50 – 55.

### **Neni 17**

Në tavolinën e gjyqtarisë mund të qëndrojnë vetëm persona zyrtarë, sipas renditjes të përcaktuar në rregullat zyrtare të lojës, ashtu që sipas renditjes, procesmbajtësi gjithnjë duhet të jetë në anën e djathtë të vëzhguesit.

Vendi i parë – matësi i 24 sekondëshit

Vendi i dytë – matësi i kohës

Vendi i tretë – vëzhguesi

Vendi i katërt – procesmbajtësi

Personi i cili punon me mikrofon, gjegjësisht me zërim, duhet të gjendet në tavolinë të veçantë, në afërsi të tavolinës së gjyqtarisë.

Zërimi shërben vetëm për dhënien e informacioneve rreth ndeshjes. Nuk lejohet përdorimi i zërimit për propagim të skuadrës, për nxitje të shikuesve, për anim, komentim të gjykimit etj.

### **Neni 18**

Skuadra vendase është e obliguar të sigurojë:

Aparaturën për matjen e kohës dhe 24 sekondëshit

Procesmbajtësin

Matësin e kohës

Matësin e 24 sekondave

Protokollin zyrtar të FBK-së – FIBA-s

Kronometrin për matjen e kohës me dorë

Kronometrin për matjen e 24-sekondëshit me dorë

Pipin

Treguesit e gabimeve vetjake

Treguesit e gabimeve personale (bonus)

Treguesin e shigjetës të zotërimit të alternuar të topit

Kompjuterin me printer për raport të vëzhguesit dhe statistikë

## **SKUADRAT, TRAJNERËT DHE PERSONAT ZYRTARË**

### **Neni 19**

Në ndeshjet e ligave mund të paraqiten vetëm lojtarët që posedojnë licencat e lëshuara nga ana e organit të FBK-së.

Detyrën e trajnerit dhe ndihmës-trajnerit mund ta kryejë vetëm personi që posedon licencën e lëshuar nga Komisioni i Trajnerëve të FBK.

Trajneri apo personi zyrtar i skuadrës, 20 minuta para fillimit të ndeshjes ia dorëzon listën e lojtarëve dhe licencat vëzhguesit të ndeshjes.

### **Neni 20**

Kontrollimi mjekësor i lojtarëve është i obliguar dhe atë dy herë, para fillimit të pjesës së parë dhe të dytë të garave gjatë një edicioni. Për lojtarët e huaj është obligativ para licencimit dhe atë të komisioni i mjekëve që përcakton bordi i FBK. Skuadra, gjegjësisht lojtari i cili nuk ka bërë kontrollimin mjekësor para fillimit të garave, nuk mund të paraqitet në ndeshje.

Neni 20 A

## **DOPING KONTROLLA- RREGULLAT E PRGJITHËSHME**

**-Të gjithë lojtarët e licencuar të cilët luajnë në garat e ligave dhe për kupë, janë të obliguar t'i nënshtrohen doping kontrollës. Doping kontrollën mund ta kryejnë kontrollorët kundër dopingut të FIBA, dhe agjensionet e autorizuara në Kosovë.**

**-Gjërat dhe metodat e ndaluara janë të përcaktuara në listen e gjërave të ndaluara të cilën e lëshon ËADA (agjencioni botëror në luftë kundër dopingut) .Lista rregullisht ndryshon, së paku një herë në vit, kurse obligim i lojtarëve dhe klubeve është të jenë të informuar për listen momentale e cila mund të gjendet në faqen e ËADA-<http://ëëë.ëada-ama.org> .**

**-Gjate garave secili ekip mund të kyqet në programin e doping kontrollës.**

**-Doping kontrolla mund të bëhet gjatë garave dhe jashtë garave, mund të bëhet me short, me qellim, (kur dyshohet për doping), si dhe në kuadër të regjistrimit të test grupit.**

**-Doping kontrolla gjatë garimit bëhet gjatë kohës së garave ose gjatë kohës së zgjatjes së manifestimit (p.sh. garat përfundimtare të kupës) 7 ditë para ndeshjes së parë ose 24 orë pas përfundimit të ndeshjes së fundit.**

**-Doping kontrolla, gjatë garimit është qfarëdo llojë e doping kontrollës jashtë kohës së garimit.**

**-Grupi i regjistruar për testim përbëhet prej lojtarëve të përcaktuar nga ana e FIBA dhe FBK, kurse mund të jenë objekt i testimit si jashtë garave, po ashtu edhe gjatë garimit.**

**-Analizat bëhen në laboratorët e akredituar të ËADA apo të agjencionit të autorizuar të Kosovës.**

## **-ZGJEDHJA E LOJTARËVE PER DOPING KONTROLLË GJATË GARIMIT**

**-Lojtarët përzgjedhen me short apo nga një komision i posaçëm, ndërmjet çerekut të tretë dhe të katërt, numri i lojtarëve të përzgjedhur të cilët duhet t'i nënshtrohen testimit është nga dy për secilin ekip, por mund të jetë edhe më i madhë, apo më i vogël.**

-Shorti mund të bëhet në fushë ose në lokal të veçant.Kontrollori i dopingut, është i obliguar t`i njoftoj mjekët e të dy klubeve para lojës, ose më së voni në gjysmëlojë,se do të bëhet doping kontrolla.

-Gjatë pushimit mes çerekut të tretë dhe të katërt të lojës,kontrollori i dopingut në prani të mjekëve të klubeve (ose personave zyrtar të klubeve) e bën shortin apo përzgjedhjen nga komisioni.Në short apo përzgjedhje hyjnë aq lojtarë për sa do të bëhet testimi,si dhe nga një lojtarë rezervë në rast të lëndimit.Vetëm lojtarët e regjistruar në protokol të lojës mund të hyjnë në short apo përzgjedhje.

-Nëse lojtari gjatë lojës lëndohet dhe i duhet ndihma spitalore,ai nuk do te merret parasysh me rastin e shortit apo përzgjedhjes .

-Nëse ekipi nuk ka mjek të pranishëm,atëherë trajneri,ose personi zyrtar ose fizioterapeuti mund të jenë të pranishëm në short apo përzgjedhje.

-Kur të përcaktohen numrat e lojtarëve për testim,kontrollori i dopingut i jep mjekut të ekipit formularin e njoftimit për doping kontrollë.

-Mjekut të ekipit i tregohet rruga deri te lokalet për doping kontrollë,kurse lojtarët e përcaktuar, përcjellësi i drejton direkt në lokalet për doping kontrollë.

-Secilit lojtar i merret urina apo çfarëdo lloj lëngu nga trupi i tijë (gjaku,djersa etj).

-Në lokalet për doping kontrollë, lojtari ose mjeku në formularin zyrtar për doping kontrollë,duhet t`i shkruaj të gjitha barërat apo preparatet të cilat i ka marrë gjatë 72 orëve para marrjes së urinës apo mostrave tjera.

#### **.SHPALLJA E REZULTATEVE**

-Në rast se testi i mostrës A është pozitiv në doping,organi kompetent (FIBA,ËADA,FBK) i paraqet FBK-s analizat se në urinën e lojtarit apo lojtarëve të testuar janë gjetur prani të mjeteve të ndaluara.

-Në rast se testi doping i urinës së lojtarit (mostra A) ka rezultuar pozitiv,lojtari mënjëherë duhet të pezullohet..

-Personi i autorizuar i garës, obligohet që njoftimin për pezullim me shkrim t`i ja dërgoj lojtarit,kryetarit të klubit,organit kompetent të doping kontrollës (FIBA,ËADA,FBK),si dhe komisionit dhe organeve të FBK.

-Në rast të testit pozitiv,pas marrjes së njoftimit,lojtari apo klubi kanë të drejtë që në llogari të vet të kërkojnë analizën e dytë,dmth analizën e mostrës B.Analizën e mostrës B, duhet kërkuar ne afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim.

**Analiza e mostrës B,duhet të bëhet në afat sa më të shkurtër në laboratorin e akredituar,kurse e bëjnë persona të ndryshëm nga ata që e kanë bërë analizën e mostrës A.**

**-Nëse në afat prej 10 ditësh, lojtari apo klubi nuk kërkon analizën e mostrës B,konsiderohet se kanë hequr dorë nga analiza e mostrës B.**

**-Sekretari i përgjithshëm i FBK,Komesari i garave të FBK ,duhet menjëherë të informohen për rezultatet e analizave të mostrës B.**

#### **NDALESA PER LOJË**

**-Për praninë e mjeteve të ndaluara,shfrytëzimi apo tentimi për shfrytëzimin e mjeteve dhe metodave të ndaluara,si dhe refuzimi i doping kontrollës, shqiptohet dënimi për ndalesë loje:**

- a).-kundërvajtja e parë,2 vite ndalesë loje,**
- b).-kundërvajtja e dytë,ndalesë e përjetshme për lojë.**

#### **-MJETET E NDALUARA**

**-Në listen e mjeteve të ndaluara të cilën e përcakton ËADA,mund të jenë mjete të përcaktuara me të cilat konsiderohet se me përdorimin e tyre pa qëllim mund të thyejnë rregullat e dopingut,sepse gjërësisht janë të pranishme në preparatet mjekësore ose që në sasi më të vogla mundën të përdoren efektivisht për doping.**

**-Nëse lojtari argumenton se me përdorimin e këtyre mjeteve nuk ka pasur qëllim të përmirësoj rezultatet sportive ,ndalesa kohore për lojë mund të jetë:**

- a).-kundërvajtja e parë,së paku vërejtje dhe qortim,kurse me së shumti ndalesë loje në kohëzgjatje prej 1 viti,**
- b).-kundërvajtja e dytë:dy vjet ndalesë loje,**
- c).-kundërvajtja e tretë:ndalesë loje për jetë.**

**-Në rast se lojtari është pozitiv në doping kontrollë, në gara të tjera (ndërkombëre) komisioni i garave duhet patjetër të pranoj dënimet e shqiptuara në ato gara (pas procedurës së duhur) me kusht që doping kontrolla, është bërë më procedure të rregullt në laboratorët a akredituar të FIBA-s,si dhe që mjeti zbuluar në të cilin lojtari është pozitiv gjendet në listën e mjeteve dhe metodave të ndaluara të cilën e shpall ËADA.**

**Neni 21**

Në bankën e lojtarëve mund të vendosen:

Trajneri

Dy ndihmës-trajnerë

Mjeku

Fizioterapeuti

Udhëheqësi teknik

Përfaqësuesi zyrtar

Gjatë ndeshjes me tavolinën zyrtare mund të kontaktoj vetëm trajneri i skuadrës.

Përfaqësuesi zyrtar i skuadrës vendase, në emër të klubit organizator është përgjegjës para vëzhguesit në lidhje me organizimin e ndeshjes.

## **Neni 22**

Komesari i Garave lëshon licencat zyrtare për:

Udhëheqësin teknik të skuadrës

Përfaqësuesin zyrtar të skuadrës

Komesari i Garave para fillimit të garave, çdo skuadre duhet t'i lëshojë më së shumti 7 (shtatë) licenca për përfaqësuesit zyrtarë. Nëse në ndeshje nuk është present asnjëri prej tyre, ata mund t'i zëvendësojë personi tjetër me licencë zyrtare (ndihmëstrajneri ose udhëheqësi teknik, por jo edhe mjeku ose fizioterapeuti).

Komesari i garave ka të drejtë të tërheq licencën e përfaqësuesve zyrtarë nëse konstatohet se sjelljet e tyre nuk janë në nivel sportiv. Në këtë rast klubi ka të drejtë të parashtojë kërkesë për lëshimin e licencave për persona tjerë.

## **Neni 23**

Për të gjitha ndeshjet lejohet të luajnë 12 lojtarë.

## **Neni 24**

Trajnerët dhe lojtarët e ftuar nga personi zyrtar i skuadrës janë të obliguar, më kërkesë të gazetarëve të marrin pjesë në PRESS – konferencë.

## **GJYQTARËT, VËZHGUESIT DHE NDIHMËSGJYQTARËT**

### **Neni 25**

Listën e gjyqtarëve e përcakton Bordi i FBK-së.

Gjyqtarët për gjykimin e ndeshjeve i cakton Komesari i Garave.

Ndihmësgjyqtarët i siguron skuadra vendase.

Klubet nuk mund të kërkojnë përjashtim të gjyqtarëve nga lista e aprovuar.

### **Neni 26**

Gjyqtarët janë të obliguar të paraqiten në palestra sportive një orë para fillimit të ndeshjes.

Gjyqtarët, të përgatitur dhe të veshur me uniformën e gjyqtarit, në fushën e lojës duhet të paraqiten 20 minuta para fillimit të ndeshjes.

Pas përfundimit të lojës, gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët mund të largohen nga fusha e lojës vetëm me lejimin dhe pëlqimin e vëzhguesit të ndeshjes.

### **Neni 27**

Në qoftë se njëri ose të dy gjyqtarët nuk paraqiten në ndeshje, vëzhguesi është i autorizuar të caktojë gjyqtarë të tjerë ,të cilët gjenden në palestër, me kusht që ata të jenë në listën e gjyqtarëve të aprovuar nga Bordi i FBK-së.

Nëse në palestër nuk gjenden gjyqtarë nga lista, atëherë vëzhguesi merr vendim për pezullimin e ndeshjes.

Terminin dhe gjyqtarët për ndeshjen e pezulluar e cakton Komesari i Ligës, ndërsa shpenzimet e përsëritura të skuadrës mike i kompenson Liga.

## **Neni 28**

Gjyqtarët janë plotësisht të pavarur në marrjen e vendimeve.

Gjyqtarët gjatë ndeshjes janë të obliguar t'i zbatojnë rregullat zyrtare të FIBAsë dhe dispozitat e këtyre propozicioneve.

Gjyqtarët janë përgjegjës për mbajtjen e rendit në fushën e lojës dhe bashkëpunimin me tavolinën e gjyqtarisë.

Gjyqtari i parë është veçanërisht përgjegjës në një pjesë të autorizimeve të parashikuara me rregullat zyrtare të lojës.

## **Neni 29**

*Gjyqtari i parë mund të ndërprerë ndeshjen nëse shikuesit e skuadrës vendase ose mike hyjnë në fushën e lojës duke shkaktuar rrahje të lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar të ndeshjes ose me gjuajtje të gjësendeve të forta në fushën e lojës dhe rreth hapësirës së bankës të skuadrave shkaktajnë lëndime të lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar të skuadrave.*

*Gjyqtari i parë është i autorizuar të përcaktojë fajtorin e ndërprerjes së ndeshjes dhe në raportin e tij hollësisht të përshkruajë ngjarjen.*

*Gjyqtari i parë merr vendim për zbrazjen e pjesshme ose tërësishme të palestrës nga shikuesit, në raste kur ndodhë tentimi sulmit fizik nga shikuesit, anim jospportiv me sharje, ofendime në çfarëdo baze ose hedhjes së gjësendeve në fushën e lojës të cilat mund të sjellin lëndime (pa pasoja lëndimi). Gjyqtari i parë duhet të ndalojë lojën, nga organizatori i ndeshjes të kërkojë marrjen e masave (përmes zërimit)për ndërprerjen e këtyre veprimeve jospportive. Në qoftë se këto veprime edhe më tutje vazhdojnë, atëherë gjyqtari i parë duhet të ndalojë lojën dhe nga organizatori të kërkojë, për herë të fundit, të merr masa për ndërprerjen e sjelljeve jospportive. Nëse edhe kjo masë e vërejtjes së fundit nuk ndikon në ndërprerjen e sjelljeve jospportive, atëherë gjyqtari I parë medoemos duhet të shqiptojë masën e dënimit për zbrazjen e pjesshme ose tërësishme të palestrës sportive nga shikuesit.*

## **Neni 30**

Gjyqtari i parë, para fillimit të ndeshjes e bën kontrollimin e protokollit të ndeshjes, a janë të shënuar të gjithë lojtarët me numra të fanellave, trajnerët dhe ndihmës-trajnerët, së pari të skuadrës vendase, të shënojnë (5) lojtarët të cilët do ta fillojnë ndeshjen. Trajnerët, me nënshkrimet e tyre në protokollin e ndeshjes vërtetojnë saktësinë e shënimeve të evidentuara në protokollin e ndeshjes.

Gjyqtarët kujdesen mbi punën e tavolinës së gjyqtarisë, ndërsa punën e ndihmësgjyqtarëve e kontrollojnë vëzhguesi i ndeshjes, i cili i ndihmon gjyqtarët të punojnë dhe gjyqtarët, që loja të zhvillohet në mënyrë të rregullt.

Gjyqtarët, ndihmësit e tyre dhe vëzhguesi i ndeshjes, nuk janë të autorizuar të lejojnë ndryshimin e rregullave zyrtare të lojës.

### **Neni 31**

Gjyqtarët, vet ose me sugjerimin e vëzhguesit, mund ta ndërrojnë gjyqtarin ndihmës, nëse konstatojnë se është duke gabuar dhe me këtë veprim ndikon në zhvillimin e rregullt të lojës. Vëzhguesi i ndeshjes e cakton ndihmësgjyqtarin e ri.

### **Neni 32**

Gjyqtarët janë të obliguar që çdo situatë kontestuese ta përshkruajnë në hollësi, duke i cekur shkaqet e gjykimit të gabimeve teknike ose përjashtimit, si dhe situatat kur bëhet zëvendësimi i ndihmësgjyqtarit, zbrazja e palestrës nga shikuesit, ndërprerja e ndeshjes etj.

### **Neni 33**

Gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët, të cilët bëjnë shkelje të dispozitave të këtyre propozicioneve dhe rregullave zyrtare të lojës dhe detyrën e tyre nuk e kryejnë në mënyrë të përcaktuar me këto propozicione, merren në përgjegjësi nga Komesari I Garave.

Në situatë kur bëhet shkelje materiale e rregullave të lojës, të cilat drejtpërdrejt kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të lojës, gjyqtarët merren në përgjegjësi nga Shoqata e Gjyqtarëve të basketbollit.

**Komisari i Garave në bazë të vlerësimit të tij për rëndësinë e ndeshjes ka të drejtë të delegojë kontrollor të ndeshjes ose këtë detyrë ta kryej vet me prezencën e tij në ndeshje.**

### **Neni 34**

Listën së vëzhguesve e përcakton Bordi i FBK-së.

Delegimin e vëzhguesve në ndeshje e bën Komesari i Garave.

Vëzhguesi është përgjegjës për punën e tavolinës së gjyqtarisë.

Detyra e vëzhguesit është të përcjellë ngjarjen në shikues, rreth tavolinës së gjyqtarisë, bankës së skuadrave dhe në rast nevojë t'i bëjë me dije gjyqtarët, në mënyrë që ata me kohë t'i ndërmarrin masat e duhura. Vëzhguesi është i obliguar që në raportin e tij të deklarojë rreth ngjarjeve kontestuese dhe të insistojë te gjyqtarët të deklarojnë në lidhje me vërejtjet e bëra nga skuadrat, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me gjykimin.

Vëzhguesi është i obliguar që më së largu 20 minuta pas përfundimit të ndeshjes të informoj Komesarin për rezultatin e ndeshjes.

### **Neni 35**

Vëzhguesi në raport e bën fletëparaqitjen ndaj personit, i cili ka bërë shkelje disiplinore dhe e merr deklaratën e tij dhe gjyqtarëve e nëse e vlerëson të arsyeshme edhe të përfaqësuesve zyrtarë të skuadrave dhe të personave tjerë.

Nga lojtari, trajneri ose përfaqësuesi zyrtar që është përjashtuar nga loja, vëzhguesi medoemos e merr deklaratën me shkrim.

### **Neni 36**

Komesari i Garave e bën regjistrimin e ndeshjeve në bazë të raporteve të vëzhguesve.

Raporti i vëzhguesit përfshin shënimet e përgjithshme të ndeshjes (organizimi i ndeshjes, sjelljet e shikuesve, lojtarëve, trajnerëve), me vërejtjet eventuale të gjyqtarëve dhe skuadrave dhe në fund, mendimi i vëzhguesit në lidhje me ndeshjen.

Vëzhguesi është i obliguar që raportin ta përpilojë në lokalet e skuadrës vendase, në praninë e përfaqësuesve zyrtarë të të dyja skuadrave.

Raporti i vëzhguesit përpilohet në 3 (tri) kopje, njëra për Komesarin e Garave dhe nga një kopje për përfaqësuesit e skuadrave.

Nëse përfaqësuesi zyrtar i skuadrës e pengon punën e vëzhguesit gjatë përpilimit të raportit, vëzhguesi mund ta largojë nga zyra.

Materialin nga ndeshja (protokolin, raportin etj), vëzhguesi është i obliguar t'ia dorëzojë Komesarit më së largu 48 orë pas përfundimit të ndeshjes.

### **Neni 37**

Përgjegjësinë disiplinore të vëzhguesit e konstaton dhe mbi të merr vendim Komesari i Garave, në bazë të dispozitave të këtyre propozicioneve.

### **Neni 38**

Në të gjitha ndeshjet e Superligës A duhet të udhëhiqet statistika për secilën skuadër veç e veç.

Nga një kopje e statistikave iu dorëzohet skuadrave dhe një Komesarit të Garave.

Mbajtësin e statistikës në ndeshje e cakton skuadra mikpritëse dhe është përgjegjëse për punën e tij.

## **DETYRAT E ORGANIZATORIT TË NDESHJES**

### **Neni 39**

Organizatori i ndeshjes është i obliguar që në çdo ndeshje të sigurojë kujdestarët e ndeshjes dhe praninë e sigurimit publik – pjesëtarët e SHPK-së (në numër të mjaftueshëm), varësisht nga madhësia e palestrës dhe numri i shikuesve.

Organizatori I ndeshjes është i obliguar t'ia prezantoj vëzhguesit shkresën mbi paraqitjen e ndeshjes organit të sigurimit publik-SHPK-ës, e vërtetuar nga ky organ për pranimin shkresës. Në qoftë se në ndeshje nuk janë të pranishëm pjesëtarët e sigurimit publik –SHPK ose nuk është numri i mjaftueshëm i tyre,atëherë gjyqtari I parë,sipas vlerësimit të tij,vendos për zhvillimin ose pezullimin e ndeshjes për 24 orë.

Në qoftë se organizatori i ndeshjes me shkresë nuk e ka paraqitur ndeshjen e organit të sigurimit publik-SHPK-ës dhe në ndeshje nuk janë të pranishëm pjesëtarët e sigurimit

publik-SHPK-së,atëherë ndeshja nuk zhvillohet dhe ekipi organizator e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë në tabelën e klasifikimit. Nëqoftëse një skuadër në këtë mënyrë i humb dy(2) ndeshje,atëherë automatikisht largohet nga garat e mëtutjeshme dhe bie në një rang më të ulët të garave.

Organizatori është i obliguar të sigurojë praninë e mjekut kujdestar, me pajisje të duhura mjekësore.

Organizatori është i obliguar të sigurojë lokalim (zyrën) dhe makinën e shkrimit, ku vëzhguesit, gjyqtarët dhe përfaqësuesit zyrtarë të skuadrave e përpilojnë raportin e vëzhguesit.

Organizatori i ndeshjes duhet të vendosë Flamurin Kombëtar në vendin e dukshëm për të gjithë pjesëmarrësit e ndeshjes.

Organizatori është i obliguar të vendosë panot e sponsoruesit të Ligës në pjesën e dukshme, për rreth fushës së lojës, dy metra larg vijës anësore.

Organizatori obligohet që të sigurojë 10 ftesa (bileta) në vende nderi për FBK.

**Çdo klub para fillimit të edicionit,duhet të autorizoj dhe të caktojë personin zyrtar i cili mund të kontaktoj zyrtarisht me Komesarin e Garave.**

#### **Neni 40**

Detyrat e organizatorit të ndeshjes janë marrja e të gjitha masave për sigurimin e kushteve normale për zhvillimin e ndeshjes.

Organizatori i ndeshjes e mbanë përgjegjësinë e plotë në rast të incidenteve gjatë dhe rreth ndeshjes, sjelljeve jospportive të shikuesve, hyrjes së tyre në fushën e lojës, pengimin e lojtarëve dhe gjyqtarëve në kryerjen e detyrës.

Skuadra mike e mban përgjegjësinë mbi incidentet, të cilat i shkaktojnë shikuesit e tyre, nëse ata kanë shkuar në ndeshje në formë të organizuar.

***Organizatori i ndeshjes e mbanë përgjegjësinë mbi sigurimin e lojtarëve, trajnerëve, përcjellësve të skuadrës mike,gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar të ndeshjes dhe është i obliguar të sigurojë largimin e tyre nga fusha e lojës, palestra dhe jashtë palestrës në largësi e cila garanton sigurinë e tyre për largimin nga vendi ku zhvillohet ndeshja.***

Organizatori i ndeshjes është i obliguar të sigurojë xhirimin e ndeshjes dhe një kopje të kasetës t'ia dorëzojë Komesarit të Garave më së largu 48 orë pas përfundimit të ndeshjes.

Organizatori i ndeshjes është i obliguar që skuadrës mike t'i sigurojë 200-300 bileta për shikuesit e saj, sipas kërkesës me shkrim.

Ndërsa, parashtruesi i kërkesës e mban përgjegjësinë për shikuesit e vet dhe I nënshtrohet sanksioneve, njëjtë sikur mikpritësi për mospërfillje të propozicione të garave.

Organizatori i ndeshjes duhet që të ju ndaloj hyrjen në palestër shikuesve të cilët me veti kan pije alkoolike,armë,mjete të ndezura.Të ju ndaloj hyrjen në palestër shikuesve nën ndikim të alkoolit,mjeteve narkotike-stimulative dhe gjërave të ngjashme.Të ju ndalohet futja në palestër flamujve,simboleve,emblemave ose teksteve të cilat me qëllim apo pa te,ndikojnë në dhunë.-Obligim i klubit është që ato menjëherë të largohen.

Organizatori i ndeshjes është i obliguar të sigurojë kushte të përshtatshme klimatike për lojë, që nënkupton temperaturën në palestër, e cila duhet të jetë 16 gradë.

Në rastet kur nuk plotësohen kushtet e duhura klimatike, ndeshja duhet të zhvillohet brenda 24 orëve vijuese.

Skuadra mike nëse pranon të luajë ndeshjen në palestrën ku nuk janë plotësuar kushtet adekuate klimatike, nuk ka të drejtë ankese.

Ndriqimi në palester duhet të jet më së paku 1500 lluksa në të gjithë hapësirën e fushës, e matur një meter mbi parket.

## **RRJEDHA E NDESHJES**

### **Neni 41**

Fillimi i ndeshjes konsiderohet që nga çasti kur në palestër hyjnë gjyqtarët dhe zyrtarisht e lëshojnë në veprim aparaturën për matjen e kohës së lojës.

Njëzet (20) minuta para fillimit të ndeshjes, gjyqtari i parë i kontrollon pajisjet teknike dhe konstaton nëse organizatori i ka përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara me këto propozicione dhe rregulla të lojës.

Në qoftë se gjyqtarët konstatojnë ndonjë lëshim në pajisje teknike, të cilat nuk lejojnë zhvillimin e ndeshjes, organizatori i japin kohë prej 30 minutave për evitimin e tyre.

Nëse gjatë kësaj kohe nuk evitohen lëshimet, atëherë ndeshja pezullohet dhe përgjegjësinë e mban organizatori.

Ndeshja e pezulluar duhet të zhvillohet brenda 24 vijuese.

Nëse lëshimet ndodhin, pasi gjyqtari i parë e ka lëshuar semaforin në veprim (20 minuta para fillimit të ndeshjes) dhe ato nuk mund të evitohen brenda asaj kohe, atëherë ndeshja pezullohet dhe ajo duhet të zhvillohet brenda 24 orëve vijuese.

Vendimin mbi këtë e merr vëzhguesi i ndeshjes.

Në marrëveshje të dyanshme, ndeshja mund të zhvillohet me pajisje ndihmëse (koha e lojës dhe 24-sekondëshi maten me kronometër dore). Vendimin mbi këtë e merr vëzhguesi i ndeshjes.

Nëse lëshimi është i tillë që nuk mund të evitohet as brenda 24 orëve, atëherë vendimin për terminin e ri të zhvillimit të ndeshjes e merr Komesari i Garave.

Në rastet e përshkruara në alinetë e këtij neni, skuadra vendase është e obliguar t'i paguajë shpenzimet e skuadrës mike për ndeshjen e pezulluar.

Nëse ndeshja nuk luhet për shkak të mosardhjes me arsye të skuadres mysafire, hargjimet e organizimit të ndeshjes, zyrtarëve të ndeshjes do t'i bartë skuadra mysafire.

Ndeshja e ndërprerë për shkak të një rasti të arsyeshëm, vazhdohet nga koha dhe rezultati i arritur në momentin e ndërprerjes.

**Komesari Garave, nëse vlerëson që është në interes të rregullsisë së garave, të vendos që të gjitha ose ndeshjet përcaktuese të luhen në të njëjten ditë me fillim në të njëjten kohë.**

**Terminet e ndeshjeve të Superliges mund të jenë:**

**-E Shtune dhe ditët e punës : prej 15:00 deri 20:00**

**-E Diele prej 12:00 deri 20:00**

### **Neni 42**

Njëzet (20) minuta para fillimit të ndeshjes, matësi i kohës, me lejin e gjyqtarit të parë, e lëshon semaforin në veprim.

Gjashtë (6) minuta para fillimit të ndeshjes, gjyqtari i parë, me sinjalin e aparaturës e bën thirrjen e lojtarëve të vendosen jashtë vijës anësore, afër bankës së skuadrës, për prezantim zyrtar.

Folësi me mikrofon, së pari e prezanton kapitenin e skuadrës, pastaj, sipas numrit të fanellës me radhë, lojtarët dhe trajnerët. Së pari prezantohet skuadra mike e pastaj ajo vendase.

Pas përfundimit të prezantimit, lojtarët e të dyja skuadrave përshëndeten dhe pastaj drejtohen në bankat e tyre.

Gjysmë minute para fillimit të ndeshjes, matësi i kohës, e kthen kohën në semafor në pozitën fillestare, ndërsa nga pesë (5) lojtarë të të dyja skuadrave hyjnë në fushë për të filluar ndeshjen.

### **Neni 43**

Mënyra e ndarjes së pikëve dhe përcaktimi i klasifikimit të skuadrave bëhet sipas rregullave zyrtare të lojës në FIBA.

### **Neni 44**

1. Skuadrës, e cila e ka fituar ndeshjen i takojnë dy (2) pikë në tabelën e klasifikimit.
2. Skuadrës, e cila e ka humbur ndeshjen, i takon një (1) pikë në tabelën e klasifikimit.
3. Skuadra, e cila pa arsye nuk paraqitet në zhvillimin e ndeshjes, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takon zero (0) pikë.
4. Skuadra e cila është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takon zero (0) pikë.
5. Skuadra e cila aktivizon lojtarin e licencuar i cili njëkohësisht luan edhe për ndonjë skuadër tjetër jashtë Kosovës humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takon 0 pikë. Në rast të përsëritjes së të njëjtit veprim skuadra largohet nga garat e mëtejme.
6. Skuadra e cila është pezulluar ose paraqitet në ndeshje me lojtarin i cili nuk është i regjistruar në këtë skuadër, i pezulluar është duke vuajtur dënimin, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:2, dhe i takon zero (0) pikë në tabelën e klasifikimit. Në qoftë se një skuadër në këtë mënyrë i humb dy (2) ndeshje, atëherë automatikisht largohet nga garat dhe bie në një rang më të ultë të garave.
7. Skuadra, e cila pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të lojës në pjesën e rregullt të garave (më përjashtim të Play-offit), e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20), i takon zero (0) pikë dhe dënohet me 1.000 euro. Në rastin e përsëritur skuadra bie në rang më të ultë të garave.
8. Skuadra, e cila është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes gjysmëfinale në Play-off, automatikisht diskualifikohet nga garat e mëtejme.
9. Skuadra e cila pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të lojës në ndeshjen gjysmëfinale dhe finale të play-offit automatikisht diskualifikohet nga garat e mëtejme dhe bie në një rang më të ultë të garave.  
Skuadra, e cila është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes finale në Play-off, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar dhe automatikisht e humb edhe ndeshjen e radhës.
10. Në qoftë se skuadra gjatë lojës mbetet me më pak se dy (2) lojtarë në fushë, e humb ndeshjen për shkak të mospërfundimit të lojës
11. Në qoftë se skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen, nuk udhëheq në rezultat, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat 2:0 në të mirë të saj. Në qoftë se skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen, udhëheq në rezultat, atëherë rezultati deri në kohën e ndërprerjes mbetet i vlefshëm. Skuadra, e cila e humb ndeshjen në këtë mënyrë e fiton një pikë në tabelën e klasifikimit.

### **Neni 45**

Në qoftë se dy skuadra, në fund kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, renditja e tyre duhet të përcaktohet në bazë të ndeshjeve të zhvilluara ndërmjet tyre.

Nëse numri i fitoreve në ndeshjet ndërmjet tyre është i barabartë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshdallimit në ndeshjet ndërmjet tyre.

Në qoftë se koshdallimi në ndeshjet e zhvilluara ndërmjet tyre është i njëjtë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshkoeficientit, duke llogaritur rezultatet e arritura në të gjitha ndeshjet e zhvilluara të të dyja skuadrave.

Koshkoeficienti çdo herë llogaritet duke e pjesëtuar numrin e koshave të shënuar me numrin e koshave të pësuar.

Në qoftë se më shumë se dy skuadra kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, atëherë renditja përcaktohet vetëm në bazë të rezultateve të ndeshjeve ndërmjet tyre.

Në qoftë se më shumë se dy skuadra kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve dhe numri i fitoreve në ndeshjet ndërmjet tyre është i barabartë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshkoeficientit, duke i llogaritur rezultatet e arritura në ndeshjet në mes tyre.

Në qoftë se më shumë se dy skuadra kanë numër të barabartë të fitoreve në ndeshjet në mes tyre dhe koshkoeficient të njëjtë, renditja duhet të përcaktohet në bazë të koshkoeficientit, duke i llogaritur të gjitha rezultatet e arritura në kuadër të Ligës.

Në qoftë se koshkoeficienti është i njëjtë, renditja duhet të përcaktohet në bazë të shortit.

Procedurën e shortit e cakton dhe e zbaton Komesari i Garave, në prani të përfaqësuesve të skuadrave.

Në qoftë se një skuadër i humb dy (2) ndeshje me rezultat zyrtar (0:2 ose 0:20), atëherë automatikisht largohet nga garat e mëtejme, renditet në fund të tabelës, kurse në edicionin e ardhshëm starton në një rang më të ulët të garave.

Në qoftë se skuadra është larguar nga gara për shkak të dy (2) ndeshjeve të humbura me rezultat zyrtar (0:20) ose i braktisë garat dhe deri në atë moment i ka zhvilluar gjysmën ose më tepër se gjysmën e ndeshjeve të Ligës, rezultatet e arritura janë të vlefshme, ndërsa ndeshjet vijuese regjistrohen me rezultat zyrtar (2:0) në të mirë të skuadrave rivale.

Në qoftë se skuadra i ka zhvilluar më pak se gjysmën e ndeshjeve të Ligës, atëherë rezultatet anulohen dhe të gjitha regjistrohen me rezultat zyrtar (2:0) në të mirë të skuadrave rivale.

Në qoftë se Komesari i Garave, në procedurën e zbatuar, në mënyrë të pakontestueshme e vërteton se ndeshja në mes të dy skuadrave është kurdisur, atëherë të dyja skuadrat largohen nga garat e Ligës.

## **ANKESAT**

### **Neni 46**

Ankesa në ndeshje paralajmërohet me nënshkrimin e kapitenit të skuadrës në protokollin e ndeshjes, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes.

Arsyetimi bëhet me shkrim në formularin e caktuar dhe i dorëzohet vëzhguesit 20 minuta pas përfundimit të ndeshjes, ndërsa faktet plotësuese në lidhje me ankesën, mund t'i plotësojë në ditën e parë të punës pas përfundimit të ndeshjes, së bashku me 300 euro të deponuara në llogarinë rrjedhëse ose në zyrat e FBK-së.

Në qoftë se ankesa aprovohet në mënyrë pozitive, mjetet i kthehen skuadrës, e cila ka parashtruar ankesë.

### **Neni 47**

Ankesa e cila nuk është e paralajmëruar me nënshkrimin e kapitenit, arsyetimi, dorëzimi me kohë dhe shuma e deponuar prej 300 euro, nuk duhet të merret në shqyrtim.

#### **Neni 48**

Komesari i Ligës-Garave vendos mbi ankesën në shkallën e parë, ndërsa vendimin e merr më së largu tre (3) ditë pas marrjes së ankesës.

Kur refuzohet ankesa, ndeshja regjistrohet me rezultatin e arritur.

Ankesa e aprovuar, sjell anulimin e ndeshjes.

Komesari i Garave e cakton terminin e zhvillimit të ndeshjes tjetër.

Ankesa në rezultatin e ndeshjes aprovohet nëse është bërë shkelja e rregullave të lojës, e cila drejtpërdrejt ka ndikuar në rezultatin përfundimtar, ose ndeshja është zhvilluar në kushte jo normale të parashikuara me këto propozicione dhe ka ndikuar që rezultati të mos jetë rrjedhojë e garës sportive.

#### **Neni 49**

Ndeshja njëherë e regjistruar ose marrja e vendimit në lidhje me ndeshjen, nuk mund të anulohet nga i njëjti organ.

#### **Neni 50**

Ankesa në ndeshjet e Play-off-it dhe ato përfundimtare për Kupën e Kosovës, I dorëzohet Komesarit, në afat prej tri (3) orëve pas përfundimit të ndeshjes.

Vendimi mbi ankesën në shkallë të parë merret në afat prej tetë (8) orëve dhe iu dorëzohet palëve me shkrim.

Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Shkallën e dytë, në afat prej tetë (8) orëve, i cili vendim duhet të merret në afat prej katër (4) orëve.

#### **Neni 51**

Në vendimin e Komesarit të Garave, skuadrat kanë të drejtë ankese.

Ankesa i parashtrohet Komisionit Arbitrar në afat prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së vendimit të Komesarit të Garave me deponim të 500 eurove.

KA të përbërë nga tre (3) anëtarë e emëron Bordi i FBK-së me mandat katër vjeçar.

KA mund të merr vendim nëse në mbledhje janë të pranishëm dy (2) anëtarë të komisionit, kurse anëtari i tretë, në lidhje me rastin mund të deklarohet me shkrim.

Detyrat dhe kompetencat e KA-së i cakton Bordi i FBK-së me akt të veçantë.

Vendimin mbi ankesën, KA duhet ta merr në afat prej tre (3) ditësh, nga dita e marrjes së ankesës.

Videohirimet si provë për faktet e prezantuara (për shkelje disiplinore të akterëve) në ankesë do të merren në konsiderim vetëm nëse materiali i xhiruar dorëzohet së bashku me ankesën.

Vendimi i KA-së është përfundimtar.

Në qoftë se ankesa aprovohet dhe rezultati anulohet, me rastin e zhvillimit të ndeshjes së përsëritur, të ardhurat dhe shpenzimet, skuadrat i ndajnë në mënyrë të barabartë.

## SHKELJET DISIPLINORE DHE DËNIMET

### Neni 52

Mbi shkeljet disiplinore të parashikuara me Nenin 53 të këtyre propozicioneve, dënimet i shqipton Komesari i Garave në shkallë të parë.

### Neni 53

Mbi shkeljet disiplinore të skuadrave, lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtarë, shqiptohen këto dënime:

#### **A - ORGANIZIMI I NDESHJES**

##### **SL F-I L2-J-K-P**

|  |                  |
|--|------------------|
| <i>1. Mosparaqitja e ndeshjes me kohë</i>  | <i>50 20 10</i>  |
| <i>2. Mungesa e pajisjeve ndihmëse</i>   | <i>50 20 10</i>  |
| <i>3. Ndriçimi i pamjaftueshëm në palestër</i>   | <i>150 50 25</i> |
| <i>4. Mossigurimi i zhveshtoreve për skuadrën mike dhe gjyqtarët</i>   | <i>100 50 25</i> |
| <i>5. Pajisjet teknike jo në rregull</i>   | <i>50 25 15</i>  |
| <i>6. Mossigurimi i kujdestarisë dhe sigurimi i dobët</i>  | <i>100 50 25</i> |
| <i>7. Mossigurimi i ndihmës së pare, mjekut kujdestar dhe bartëses për të lënduar</i>                          | <i>150 50 25</i> |
| <i>8. Mosparaqitja e lojtarëve me fanella dhe brekë me ngjyrë të njëjtë dhe dukshmëria jo e mire e numrave</i> | <i>50 25 15</i>  |
| <i>9. Mungesa e licencave dhe e kontrollit mjekësor të lojtarëve</i>   | <i>50 25 15</i>  |
| <i>10. Mos sigurimi i lokalit (zyrës) dhe kompjuterit me printer për përpilimin e raportit të vëzhguesit</i>   | <i>50</i>        |
| <i>11. Mossigurimi i dy (2) topave për skuadrën mike për nxehe para fillimit të ndeshjes</i>                   | <i>50 25 15</i>  |
| <i>12. Mossigurimi i procesverbalit dhe protokollit të ndeshjes</i>  | <i>50 25 15</i>  |
| <i>13. Mosmbajtja e statistikës</i>  | <i>50</i>        |
| <i>14. Mossigurimi i ftesave dhe vendeve nderi për FBK-n.</i>  | <i>500</i>       |

*Në rastet e përsëritura, dënimi dyfishohet krahasuar me dënimin e parë.  
Dënimet e parashikuara për shkeljet disiplinore nën A –*

*“Organizimi i ndeshjes”, konsiderohen si dënime administrative (mandatarë), në të cilat nuk lejohet parashtrimi i ankesës.*

***B – SJELLJET JOSPORTIVE TË SHIKUESVE GJATË NDESHJES***

***SL F-L1 L2-J-K-P***

*1. Hedhja e gjësendeve të buta në fushën e lojës të parrezikshme, të përsëritura gjatë ndeshjes edhe pas vërejtjeve të gjyqtarëve (letra të vogla, lësh letrash, sende të tjera nga letra etj) të cilat nuk ndikojnë në rrjedhën normale të lojës*

*50 25 10*

*2. Pengimi i punës së tavolinës së gjyqtarisë nga shikuesit dhe personave të paautorizuar me ndikim në rrjedhën normale të lojës*

*100 50 25*

*3. Sjelljet josportive të shikuesve (ofendime dhe sharje në baza familjare, racore, etnike dhe fetare, të përsëritura edhe pas vërejtjes së gjyqtarëve, ndaj lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve, personave zyrtar të skuadrës si dhe shikuesve të skuadrës kundërshtare*

*100 50 25*

*\* Në qoftë se pas ofendimeve dhe sharjeve të pandërprera gjyqtarët marrin vendim për zbrazjën e pjesërishme ose tërësishme të palestrës, fajtori dënohet me një (1) ndeshje pa praninë e shikuesve.*

*4. Hedhja e mjeteve eksploduese dhe të ndezura në mesin e shikuesve*

*100 50 25*

*\* Në qoftë se mjetet e ndezura, për shkak të tymit të dendur, detyrojnë gjyqtarët të ndalojnë lojën (ndërprerje prej 10 e më shumë minuta)*

*150 50 25*

*5. Hedhja e mjeteve të vogla eksploduese (bombola) në fushën e lojës pa rrezik të lëndimit të lojtarëve dhe gjyqtarëve*

*50 25 15*

*6. Kërcënime ndaj lojtarëve,*

*gjqtarëve, vëzhguesit dhe personave tjerë zyrtar para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes*

*150 100 50*

*7. Përdorimi i zërimit zyrtar për nxitje në anim jo korrekt, dhunë dhe sjellje tjera josportive*

*100 50 25*

*8. Hedhja e gjësendeve të forta në hapësirën rreth bankës së skuadrës dhe tavolinës së gjyqtarisë të cilat mund të ndikojnë në lëndimin e lojtarëve dhe personave tjerë zyrtar (monedha hekuri, gurë, letfa dërrase, shishe qelqi, shufra hekuri, kanaqe dhe shishe plastmasi të mbushura në lëngje ose ujë) që shkaktojnë ndërprerjen e përkohshme të lojës nga gjyqtarët*

*100 50 25*

*9. Hedhja e gjësendeve të forta (shkrepsa, celular, gurë, porta, etj) në fushën e lojës të cilat mund të ndikojnë në lëndimin e lojtarëve dhe gjyqtarëve që mund të shkaktojnë ndërprerjen e përkohshme të lojës nga gjyqtarët*

*100 50 25*

*10. Hedhja e mjeteve eksplozive dhe të ndezura (petardë) në fushën e lojës të cilat mund të ndikojnë në lëndimin e lojtarëve dhe gjyqtarëve të cilat shkaktojnë ndërprerjen e përkohshme të lojës nga gjyqtarët*

*150 50 25*

*\* Në qoftë se gjyqtari i parë merr vendim mbi zbrazjen e pjesshme ose tërësishme të shikuesve nga palestra për shkak të përsëritjes të veprimeve josportive të shikuesve nga pikat 8,9 dhe 10 fajtori dënohet me \* një (1) ndeshje pa praninë e shikuesve.*

*\* Në qoftë se incidentin e shkaktojnë shikuesit e skuadrës mike, sipas nenit 40, alineja 6 për rastet e përshkruara nën B "Sjelljet josportive të shikuesve gjatë ndeshjes" për pikat 1,2,3,4,5,6,*

*7,8,9 dhe 10, atëherë dënimi i shqiptohet skuadrës mike.*

*11. Në qoftë se incidenti shkakton ndërprerjen e lojës nga shikuesit vendas me pamundësi të vazhdimit të saj \* 1-3 ndeshje pa praninë e shikuesve*

*\* Në raste më të rënda (me pasoja lëndimi të lojtarëve ose gjyqtarëve)  
\* 1-3 ndeshje moslojë në fushën e vet*

*\* Në qoftë se incidenti shkakton ndërprerjen e lojës me pamundësi të vazhdimit nga shikuesit e skuadrës mike*

*500 250 50*

*Ose një ndeshje pa prezencën e shikuesve në ndeshjen e radhës si nikoqir.*

*Dënimet e shqiptuara me të holla, me përjashtim të atyre me ndalesë të pranisë së shikuesve dhe me ndalesë moslojë në fushën e vet(pika 3,20 dhe 11) konsiderohen si dënime administrative (mandatarë) në të cilat nuk lejohet parashtrimi i ankesës.*

### **C – SULMI FIZIK I SHIKUESVE**

*1. Hyrja e shikuesve në fushën e lojës me kërcënime dhe tentim i sulmit fizik ndaj lojtarëve, gjyqtarëve, vëzhguesit dhe personave tjerë zyrtar gjatë lojës dhe pas përfundimit të saj*

*500 250 150*

*-Ose një ndeshje pa prezencën e shikuesve.*

*2. Tentim i sulmit fizik jashtë fushës së lojës(në palestër dhe jashtë saj)i shikuesve ndaj lojtarëve,gjyqtarëve, vëzhguesit dhe personave të tjerë zyrtar*

*500 250 150*

*-Ose një ndeshje pa prezencën e shikuesve.*

*3. Realizim i sulmit fizik (grushtime, shkelmime,flakaresha,goditje me kokë,goditje me gjësende të forta etj) nga shikuesit vendas ndaj lojtarëve,gjyqtarëve, vëzhguesit dhe personave tjerë zyrtarë gjatë lojës me ndërprerjen e ndeshjes me pamundësinë e*

vazhdimit të saj

\* 2 ndeshje moslojë në fushën e vet

\* Në raste më të rënda me pasoja lëndimi të lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtarë \* 3-8 ndeshje ndalesë moslojë në fushën e vet

4. Realizimi i sulmit fizik (grushtime, shkelmime, flakaresha, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta etj) nga shikuesit e skuadrës mike, kur paraprakisht është respektuar Neni 40, alineja 6, ndaj lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar me ndërprerjen e ndeshjes me pamundësi të vazhdimit të saj

1.000 500 250

-Ose 2 ndeshje pa prezencën e shikuesve, ne ndeshjen e radhës si nikoqir.

5. Realizimi i sulmit fizik (grushtime, shkelmime, flakaresha, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta etj) nga shikuesit vendas ndaj lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar para dhe pas përfundimit të ndeshjes në brendi ose jashtë palestrës sportive

\* 2-3 ndeshje pa praninë e shikuesve

\* Në raste më të rënda me pasoja lëndimi

\* 1-3 ndeshje moslojë në fushën e vet

6. Realizimi i sulmit fizik (grushtime, shkelmime, flakaresha, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta etj) nga shikuesit e skuadrës mike, kur paraprakisht është respektuar Neni 40, alineja 6, ndaj lojtarëve, gjyqtarëve dhe personave tjerë zyrtar para dhe pas përfundimit të ndeshjes në brendi ose

1.000 500 250

jashtë palestrës sportive

-Ose 2-3 ndeshje pa praninë e shikuesve ne ndeshjet e radhës si nikoqir.

\*Ne raste me te rënda me pasoja lëndimi \*1-3 ndeshje moslojë ne fushën e vet si nikoqir.

\* Në rastet e përsëritura nën 1,2,3, 4,5 dhe 6 dënimi dyfishohet në Krahasim me dënimin e parë.

*\* Në të gjitha rastet e realizimit të Sulmit fizik të përshkruara nën 5 dhe 6 nevojitet verifikimi me shkrim i organit të sigurimit publik-SHPK-ës dhe konstatimi i institucionit mjekësor mbi lëndimet e pësura.*

*\* Dënimet e shqiptuara nën C “Sulmi fizik i shikuesve”, pikat 1 dhe 2 konsiderohen dënime administrative (mandatare), në të cilat nuk lejohet parashtrimi i ankesës, ndërsa në pikat tjera lejohet parashtrimi i ankesës.*

#### ***D – SJELLJET JOSPORTIVE TË LOJTARËVE, TRAINERËVE DHE PERSONAVE ZYRTAR***

##### ***SL F-L1 L-2-J-K-P***

##### ***1. Gabim teknik i shqiptuar:***

*\* Lojtarit 50 25 15*

*\* Trajnerit 75 50 25*

##### ***2. Gabim i përjashtimit i shqiptuar:***

*\* Lojtarit 100 50 25*

*\* Trajnerit 150 75 50*

*\* Personit zyrtar të skuadrës 150 75 50*

*Dënimi për gabimin e përsëritur*

*Për lojtarin:*

*I dyti 100 50 25*

*Secili me radhë i shqiptuar 100 50 25*

*I njëjti procedim zbatohet edhe për trajnerin dhe personin zyrtar të skuadrës.*

*Dënimet e shqiptuara lojtarëve dhe trajnerëve paguhen në emër të tyre.*

*Në qoftë se pagesa e dënimit nuk kryhet në afatin e caktuar, atëherë pason pezullim i menjëhershëm i lojtarit ose trajnerit.*

***3. Mosparaqitja e personit zyrtar të skuadrës në zyre për përpilimin e raportit të vëzhguesit***

*50 25 15*

***4. Refuzim i dhënies së deklaratës pas ndeshjës nga personi i paraqitur nga gjyqtarët ose vëzhguesi***

*50 25 15*

***5. Në rastin e përjashtimit të lojtarit nga loja me paraqitje nga ana e vëzhguesit apo gjyqtarëve sjell***

pezullimin e menjëhershëm.

Pezullimi i menjëhershëm zgjatë më së shumti për një (1) ndeshje.

6. Sjelljet josportive të përfaqësuesve Zyrtar, trajnerëve dhe udhëheqësisë së skuadrave ndaj gjyqtarëve dhe vëzhguesit para, gjatë dhe pas ndeshjes (fyerje, kërcënime etj)

100 50 25

7. Sjelljet josportive të lojtarëve dhe trajnerëve ndaj shikuesve të ndeshjes

100 50 25

8. Sjelljet josportive të lojtarëve, trajnerëve dhe përfaqësuesve zyrtar të skuadrave (fyerje, kërcime etj) të cilat nuk janë ndëshkuar nga gjyqtarët gjatë ndeshjes si dhe pas përfundimit të saj, por paraqiten nga vëzhguesi i ndeshjes

150 50 25

9. Lojtarët, trajnerët dhe përfaqësuesit zyrtar të skuadrës të cilët haptazi nëpër mediume në mënyrë josportive kritikojnë gjykimin dhe gjyqtarët

150 50 25

10. Në qoftë se vije deri te rrahja e përgjithshme në mes të lojtarëve, pjesëmarrësit në rrahje (të përjashtuar nga loja) dënohen, secili

150 100 50

\* Në raste më të rënda me \* 2-3 ndeshje ndalesë mos lojë

11. Ndëshkim me gabim të përjashtimit pas të cilit i ndëshkuari tenton sulm fizik, fyen ose kërcënon gjyqtarin ose vëzhguesin

250 150 50

Ose 1-3 ndeshje moslojë

12. Tentim i sulmit fizik i lojtarit ndaj lojtarit, trajnerit ose personit zyrtar të skuadrës kundërshtare, para, gjatë ose pas përfundimit të ndeshjes brenda ose jashtë palestrës sportive (me paraqitjen e vëzhguesit)

Ose 1-5 ndeshje moslojë ose mos kryerje të detyres.

250 150 50

13. Tentim i sulmit fizik i trajnerit ndaj lojtarit, trajnerit ose personit zyrtar të skuadrës kundërshtare para, gjatë ose pas ndeshjës

*brenda ose jashtë palestrës  
sportive(me paraqitjen e vëzhguesit)  
Ose 1-5 ndeshje moslojë ose moskryerje të detyrës.*

*250 150 50*

*14. Tentim i sulmit fizik i lojtarit,  
trajnerit ose personit zyrtar të  
skuadrës ndaj gjyqtarëve ose  
vëzhguesit para,gjatë ose pas  
ndeshjes brenda ose jashtë palestrës  
sportive –Ose ndalesë moslojë ose moskryerje të detyres 1-8 ndeshje.*

*500 250 150*

*15. Tentim i sulmit fizik i lojtarëve,  
trajnerëve dhe përfaqësuesve  
zyrtar të skuadrës  
(kolektivisht) ndaj gjyqtarit(ve)  
para,gjatë dhe pas ndeshjes brenda  
ose jashtë palestrës sportive,  
dënohet, sipas përgjegjësisë individuale  
\* deri një (1) vit ndalesë moslojë ose kryerje  
detyre*

*16. Realizimi i sulmit fizik  
(grushtime,shkelmime,flakaresha,  
doditje me kokë ose gjësende  
të forta etj) i lojtarit ndaj  
lojtarit kundërshtar gjatë lojës  
\* Në raste më të rënda me pasoja  
lëndimi më së paku ndalesë një (1) vit deri  
përjetë moslojë.*

*1.000 500 250*

*17. Në qoftë se lojtari i provokuar  
nga kundërshtari në afekt e godit  
në një çast (një herë) me grushtim  
shkelmim,flakaresh ose me  
kokë,pa pasoja lëndimi*

*300 150 50*

*\* Në raste më të rënda me pasoja  
lëndimi më së paku ndalesë \* 1-3 vjet  
moslojë.*

*18. Realizimi i sulmit fizik (grushtim,  
shqelmim,flakaresh,goditje  
me kokë,goditje me gjësende të  
forta etj) i lojtarit ndaj  
gjyqtarit ose vëzhguesit,lojtarit,trajnerit ose perf.zyrtar te skuadres kundershitare  
para,  
gjatë dhe pas ndeshjes brenda  
ose jashtë palestrës -2-10 ndeshje(kampionale ose kupë) moslojë*

*1.500 500 250*

*\* Në raste më të rënda me  
pasoja lëndimi më së paku ndalesë \* një (1) vjet  
deri*

*përjetë mosloje ose moskryerje të detyres.*

*19. Realizim i sulmit fizik (grushtim, shqelmim, flakaresh, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta etj) i trajnerit ndaj gjyqtarit ose vëzhguesit para, gjatë ose pas ndeshjes brenda ose jashtë palestrës (me paraqitje të vëzhguesit) 1.500 500 250*

*\* Në raste më të rënda me pasoja lëndimi më së paku ndalesë \* një (1) vjet deri përjetë moskryerje detyre.*

*20. Realizimi i sulmit fizik (grushtim, shqelmim, flakaresh, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta i personit zyrtar të skuadrës ndaj gjyqtarit ose vëzhguesit para, gjatë dhe pas ndeshjes, brenda ose jashtë palestrës sportive (me paraqitje të vëzhguesit)*

*1.500 500 250*

*\* Në raste më të rënda me pasoja lëndimi më së paku ndalesë \* një (1) vjet deri përjetë moskryerje detyre.*

*21. Realizim i sulmit fizik (grushtime, shqelmime, flakaresha, goditje me kokë, goditje me gjësende të forta etj) e lojtarit, trajnerit ose personit zyrtar të skuadrës ndaj lojtarit, trajnerit ose përfaqësuesit të skuadrës kundërshtare para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes brenda ose jashtë palestrës sportive (me paraqitje të vëzhguesit)*

*1.000 500 250*

*\* Në raste më të rënda me pasoja lëndimi më së paku ndalesë \* 1-3 vjet mosloje ose kryerje detyre.*

*Për rastet e përshkruara më sipër të realizimit të sulmit fizik të trajnerit të skuadrës përfshihet edhe veprimi i ndihmëstrajnerit.*

*22. Për incidentet të cilat ndodhin para, gjatë dhe pas ndeshjes, por nuk janë paraqitur nga gjyqtarët ose vëzhguesi i ndeshjes, Komesari i Ligës mund të hapë procedim disiplinor për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të personave dhe skuadrave, duke i përdorë si prova deklaratat (nga anëtarët e Bordit dhe Kryetarit të Këshillit profesional të FBK-s), video xhirimet ose vetë prania e tij në këto ngjarje. Anëtarët e Bordit dhe Kryetari i Këshillit profesional nuk mund të japin deklaratat për ndeshjet ku janë të involvuara skuadrat në të cilat ata bartin ndonjë funksion.*

□ Dënimet e shqiptuara nën D “Sjelljet jospportive të lojtarëve, trajnerëve dhe personave zyrtar”, me përjashtim të pikave 16 (dënimi kohor), 17 (dënimi kohor), 18, 19, 20 dhe 21 konsiderohen dënime administrative (mandatare) dhe në to nuk lejohet parashtrimi i ankesës Komisionit Arbitrar të FBK-s.

#### **E – KRYERJA E PAPËRGJEGJSHME E DETYRAVE TË GJYQTARËVE, VËZHguesve dhe NDIHMËSGJYQTARËVE**

1. Kryerja e papërgjegjshme e detyrës (mosrespektimi dhe moszbatimi i Propozicioneve të garave, Rregullave zyrtare të lojës, udhëzimet e Komesarit të garave dhe organeve të FBK-s), sjelljet jospportive të gjyqtarëve dhe vëzhguesve para, gjatë dhe pas ndeshjes:

\* Dënimi me mosdelegim prej 1-6 ndeshje në tempo të delegimit.

2. Paraqitja në ndeshje pa uniformën e gjyqtarit:

\* Dënimi me mosdelegim në 1-2 ndeshje në tempo të delegimit.

3. Paraqitja me vonesë në palestrën sportive deri 10 minuta:

\* Dënimi me mosdelegim në një (1) ndeshje në tempo të delegimit.

4. Paraqitja me vonesë në palestrën sportive prej 15-30 minuta:

\* Dënimi me mosdelegim në dy (2) ndeshje në tempo të delegimit.

5. Paraqitja me vonesë në palestrën sportive më shumë se 30 minuta:

\* Dënimi me mosdelegim në pesë (5) ndeshje në tempo të delegimit.

6. Paraqitja me vonesë në fushën e lojës (20 min. para fillimit) deri 5 minuta:

\* Dënimi me mosdelegim prej një (1) ndeshje në tempo të delegimit.

7. Paraqitja me vonesë në fushën e lojës prej 5-10 minuta:

\* Dënimi me mosdelegim prej tri (3) ndeshje në tempo të delegimit.

8. Mosparaqitja pa arsye në ndeshjen e deleguar, pa e lajmëruar më parë Komesarin ose zyrën e FBK-s:

\* Fshirja nga lista e delegimit për edicionin garues.

9. Konsumimi i alkoolit i personave zyrtar të ndeshjes gjatë ditës së zhvillimit të ndeshjes (kryerja e detyrës në gjendje të alkoolizuar):

\* Dënimi me më së paku dhjetë (10) ndeshje mosdelegimi në tempo të delegimit ose fshirja nga lista e delegimit.

10. Gjykimi i dobët në ndeshje, sipas vlerësimit të vëzhguesit ose kontrollorit të ndeshjes:

\* Dënimi prej 2-3 ndeshje mosdelegimi në tempo të delegimit.

11. Bërja e gabimit material të Rregullave të lojës, sipas vlerësimit të vëzhguesit ose kontrollit të ndeshjes por pa ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes:

\* Dënimi prej 2-3 ndeshje mosdelegim në tempo të delegimit.

12. Bërja e gabimit material të Rregullave të lojës, me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes:

\* Dënimi prej më së paku dhjetë (10) ndeshje mosdelegimi në tempo të delegimit deri te fshirja nga lista e gjykimit për edicionin garues.

13. Paraqitja jo-objektive e fakteve ose heshtja e ngjarjeve në ndeshje ku kanë ndodhur incidente ose sjellje jospportive, bërja e gabimit material të Rregullave lojës, gjykimi i dobët etj :

\* Dënimi prej 2-5 ndeshje mosdelegimi në tempo të delegimit ose në raste më të rënda fshirja nga lista e delegimit për edicionin garues.

**14. Mossjellja me kohë e materialit të ndeshjes si dhe përpilimi i pasaktë i protokollit të lojës ose raportit të vëzhguesit të ndeshjes:**

*\* Dënimi prej 1-3 ndeshje mosdelegimi në tempo të delegimit.*

**15. Gjyqtari ose vëzhguesi i cili haptazi nëpër medime në mënyrë josportive dhe jokorrekte kritikon kolegët ose organet e FBK-s në lidhje me garat:**

*\* Dënohet me mosdelegim në 3-6 ndeshje në tempo të delegimit Në raste më të rënda fshirja nga lista e delegimit.*

**16. Gjyqtari ose vëzhguesi i cili pranon dhurata ose gostitet nga klubet para ndeshjes ose në ditët kur nuk zhvillohet ndeshja:**

*\* Dënohet me fshirje nga lista e delegimit për edicionin garues dhe i parashtrohet fletëparaqitja organit disiplinor të FBK-s.*

**17. Gjyqtari ose vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj lojtarit, trajnerit ose personit zyrtar të skuadrës:**

*\* Dënohet me fshirje nga lista e delegimit për edicionin garues dhe i parashtrohet fletëparaqitja organit disiplinor të FBK-s.*

**18. Gjyqtari ose vëzhguesi i cili tenton apo realizon sulmin fizik ndaj kolegut apo vëzhguesit ose vëzhguesi ndaj gjyqtarit:**

*\* Dënohet me fshirje nga lista e delegimit dhe I bëhet fletëparaqitja organit disiplinor të FBK-s.*

**19. Gjyqtari ose vëzhguesi i cili nuk merr pjesë në Seminaret dhe testimet e obligueshme para dhe gjatë edicionit garues:**

*\* Dënohet me fshirje nga lista e delegimit për edicionin garues.*

## **F- SHKELJET KUNDËR MARKETINGUT TË LIGËS**

Shkelja e parë..... 250 euro

Shkelja e dytë..... 500 euro

### **Neni 54**

Skuastra, e cila nuk e respekton nenin 39 alineja 7.....300 euro

Skuastra, e cila nuk e respekton nenin 12..... 500 euro

Skuastra, e cila nuk e respekton nenin 40 alineja 6.... 500 euro

Skuastra, e cila nuk e respekton nenin 10.....150 euro

Skuastra, e cila në ndeshje nuk paraqitet me

formacion komplet, në protokollin e ndeshjes,

12 lojtarë..... 50 euro

### **Neni 55.**

Të gjitha dënimet në te cilat nuk lejohet e drejta e parashtrimit të ankesës(për klube,lojtarë,trajnerë dhe personat tjerë zyrtar) duhet të paguhet më së voni 24 orë para ndeshjes së pare vijuese,në të kundërtën pason suspendimi automatik.

Vendimet e Komisionit Arbitrar duhet të realizohen më së voni 24 orë para fillimit të ndeshjes,përndryshe pason suspendimi automatik.

Dënimet me zhvillim të ndeshjes pa publik fillojnë me ndeshjen e parë si vendas sipas kalendarit të garave.

#### **Neni 56**

Dënimet me ndalesën moslojë ose mosushtrim të detyrës, vlejnë vetëm në ndeshjet zyrtare, të organizuara nga FBK.

#### **Neni 57**

Në rast se dënimi i shqiptuar nuk është kryer brenda stinorit, do të bartet në stinorin tjetër, pa marrë parasysh rangun e garimit apo ndërrimin e skuadrës.

#### **Neni 58**

Skuadra, e cila dënohet me të holla brenda xhiros, pagesën duhet ta bëjë deri para xhiros së ardhshme, përndryshe, ndeshjen e humb me rezultat zyrtar (0:20) dhe I takon zero (0) pikë.

#### **Neni 59**

Për sjelljet josportive të skuadrave, lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe personave zyrtarë, në Shkallën e parë (I), merr vendime Komesari i Garave. Ankesat në vendimet e Komesarit të Garave parashtrihen në KA të FBK-së, e cila vendosë në Shkallën e dytë (II) vendimmarrëse. Vendimet e KA të FBK-së janë përfundimtare.

#### **Neni 60**

Të gjitha vendimet që janë marrë nga Komesari i Garave dhe KA bëhen me shkrim dhe iu dërgohen palëve të interesuara deri para fillimit të ndeshjes.

### **G – DISPOZITAT FINANCIARE**

#### **Neni 61**

Gjatë garave, skuadrat i heqin shpenzimet e tyre rreth organizmit të ndeshjeve dhe udhëtimit në ndeshje.

#### **Neni 62**

Skuadrat vendase e bëjnë pagesën e shpenzimeve të gjyqtarëve dhe vëzhguesit, në bazë të vendimit të Bordit të FBK-së. Për ndeshje suplementare në teren neutral shpenzimet i bartin skuadrat pjesëmarrëse në mënyrë të barabartë.

#### **Neni 63**

Gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve iu takojnë taksa, mëditja dhe shpenzimet e udhëtimit.

Gjyqtarëve dhe vëzhguesit, të cilët e kryejnë detyrën, e cila zhvillohet në vendbanimin e tyre, nuk iu takon mëditja.

Ndihmësgjyqtarët e ndeshjes i cakton skuadra vendase, njëherësh e bën edhe pagesën e taksës së tyre.

#### **Neni 64**

Lartësinë e taksës, mëditjes dhe shpenzimeve të rrugës të gjyqtarëve dhe vëzhguesit e përcakton Bordi i FBK-së.

Taksa për gjyqtarët e huaj do të caktohet në bazë të marrëveshjes reciproke Komesari i Garave – gjyqtarë.

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 65**

Situatat të cilat nuk janë parashikuar në këto propozicione vendosen në bazë të rregullave zyrtare të lojës, statutit, rregulloreve dhe akteve të tjera normative të FBKsë.

#### **Neni 66.**

Këto propozicione hyjnë në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i FBK-së dhe vlejnë për edicionin 2009/10. Këto propozicione publikohen në ueb faqen zyrtare të FBK [ëëë.basketbolli.com](http://ëëë.basketbolli.com)

#### **Neni 67.**

Të gjitha informatat dhe vendimet e shqiptuara nga Komesari i Garave e të publikuara në ueb faqen zyrtare të FBK [ëëë.basketbolli.com](http://ëëë.basketbolli.com) janë zyrtare.

#### **Neni 68.**

Nene të caktuara të këtyre propozicioneve mund të ndryshojnë edhe gjatë edicionit të garave nëse merren me konensus të plotë me klubet e Ligës përkatëse ku bëhen ndryshimet.

*Shtylla e parë e dënimeve vlen për Superligë, e dyta për Ligën e parë dhe Ligën e Femrave , e treta për Ligën e Dytë si dhe Ligat e Juniorëve, kadetëve dhe pionierëve.*

*Komunikimi zyrtar me Komesarin e Garave bëhet me anë të faksit 038-223-755 dhe ne tel 044 506 483 si dhe në adresën elektronike [komesari@basketbolli.com](mailto:komesari@basketbolli.com), [federata@basketbolli.com](mailto:federata@basketbolli.com)*

**Komesari i Garave:**  
**Nazmi PAÇARADA**

**Kryetari i FBK-së**  
**Erold Belegu**